



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:101560

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554111

C.nr.3781/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses F.B nga fshati S, Komuna I, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Zyra për Shërbime Juridike “P.J”, me seli në P, kundër të paditurit K.SH.M “R”, me seli në P, Rr. “M.Z” nr....., në çështjen juridike anulim i vendimit dhe kthim në vendin e punës, jashtë seancës gjyqësore, me datën 05.04.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditëses F.B nga fshati S, Komuna I, e cila evidentohet nën shenjën C.nr.3781/20, e ushtruar me datë 24.08.2020, kundër të paditurit K.SH.M “R”, me seli në P, në çështjen juridike anulim i vendimit dhe kthim në vendin e punës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Paditësja F.B nga fshati S, Komuna I, pranë kësaj Gjykate, me dt.24.08.2020 ka parashtruar padi kundër të paditurit K.SH.M “R”, me seli në P, me objekt kontesti anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.3781/20, të dt.01.12.2020, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha provat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit, në mënyrë që t’i ofrohet mundësia për paraqitjen e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së Përmes përgjigjes në padi, të deponuar në këtë Gjykatë me dt.21.12.2020, pala e paditur e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

Bazuar në faktin se janë përmbushur të gjitha prezumimet procedurale, Gjykata në kuptim të dispozitës nga neni 400 par.1 të LPK-së ka caktuar dhe ka mbajtur seancën përgaditore me dt.18.03.2024, me ç’rast përfaqësuesi i autorizuar i paditëses e ka njoftuar Gjykatën lidhur me

faktin se paditësja ka ushtruar padi e cila evidentohet nën shenjën C.nr.724/21, përmes së cilës ka kërkuar anulimin e vendimeve të të paditurës ..., të dt.08.01.2021 dhe vendimit ..., të datës 18.01.2021. Mbi këtë bazë, ka propozuar bashkimin e këtyre lëndëve dhe marrjen e një aktgjykimi të vetëm.

Përmes parashtresës së deponuar në këtë Gjykatë me dt.20.03.2024, paditësja e ka njoftuar Gjykatën se e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore, me arsyetim se me të paditurën kanë arritur ujdi lidhur me këtë kontest.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*. Tutje, paragrafi 2 i të njejtës dispozitë përcakton që: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.”*

Meqenëse në rastin konkret tërheqja e padisë është bërë pas fazës së paraqitjes së përgjigjes në padi nga ana e palës së paditur, Gjykata përmes njoftimit të dt.21.03.2024, e ka njoftuar të njejtin lidhur me këtë veprimin procedural të palës paditëse, duke e ftuar që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, të deklarohet lidhur me faktin nëse e jep pëlqimin për tërheqjen e padisë, në kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 261 par.2 të LPK-së. Njoftimi në fjalë rezultoi që është pranuar nga ana e të paditurit me dt.27.03.2024 (fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa postare, e nënshkruar në të njejtën datë). Meqenëse pala e paditur nuk është deklaruar brenda afatit të përcaktuar, Gjykata konsideron që është dhënë pëlqimi lidhur me tërheqjen e padisë. Bazuar në këto rrethana, janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*. Në anën tjetër, në kuptim të paragrafit 5 të të njejtës dispozitë, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe nuk ekziston ndonjë pengesë e karakterit procedural që të paraqitet në gjykatë përsëri.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se kjo çështje kontestimore ka përfunduar me tërheqjen e padisë nga ana e palës paditëse, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve të kësaj procedure.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2020:101560
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05554111

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
C.nr.3781/2020, datë 05.04.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 261 par.4 të LPK-së, nuk lejohet ankesa.